



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 24 Janar 2017

NJOFTIM

Rritet shfrytëzueshmëria e shërbimeve elektronike

35.734 persona të siguruar i kanë shfrytëzuar shërbimet elektronike të Fondit për sigurim shëndetësor

Për t'a avansuar dhe lehtësuar komunikimin mes Fondit për sigurim shëndetësor dhe personave të siguruar, punonjësve mjekësor dhe firmave, Fondi mundësoi paketë të shërbimeve elektronike nëpërmjet të cilave të siguruarit do të mund t'a shfrytëzojnë të drejtën ligjore të kujdesit shëndetësor nga shtëpitë e tyre ose nga vendet e punës respektivisht, pa ardhur nëpër sportelet e njësive rajonale të Fondit.

Nga fillimi i zbatimit të shërbimeve elektronike, të siguruarit, të punësuarit mjekësor dhe persona të autorizuar i kanë shfrytëzuar shërbimet elektronike nga shtëpitë e tyre ose vendet e punës dhe kanë parashtruar kërkesë për të realizuar ndonjë të drejtë të sigurimit shëndetësor. Në vazhdim Ju paraqesim tabelën e shërbimeve elektronike më të shfrytëzuara:

Verifikimi i paisjeve ortopedike	31.015
Kërkesa për in-vitro	1.142
Raporte për ndërprerjen e përkohshme të punës	2.053
Propozime për vlerësimin e ndërprerjes së përkohshme të punës	1.524

Shërbimi më i shfrytëzuar elektronik është verifikimi i paisjeve ortopedike të cilën e kanë shfrytëzuar 31.015 persona të siguruar të cilët, në mënyrë elektronike i kanë dorëzuar dokumentet përmjes mjekëve amë dhe mjekëve specialist.

Shërbimet elektronike cilësohen si të dobishme dhe me rëndësi të madhe pasi mundësojnë një proces transparent dhe të drejtë ashtu që i siguruari/ personi i autorizuar i firmës në çdo kohë do mund t'a ndjekë statusin e kërkesës, të kenë informatë deri ku ka arritur procedura e përpunimit të lëndës dhe në rastet kur kërkesa të jetë e miratuar do mund t'a dijnë kur do të realizohet pagesa, do të kursejë në para dhe në kohë, pa qenë nevoja të shkojë nëpër sportelet e njësive rajonale të Fondit.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Me këtë rast i inkurajojmë të siguarit, punonjësit shëndetësor dhe firmat që sa më shumë t'i shfrytëzojnë shërbimet elektronike të Fondit. Për informatë më të saktë dhe të thjeshtësuar sa i përket procedurës dhe mënyrës si duhet të shfrytëzohet shërbimi elektronik, Fondi ka pregaditur video të titruara që shërbejnë si udhëzues për shfrytëzimin e shërbimeve elektronike.

Videot e titruara janë të shpallura në web faqen e Fondit në linkun në vazhdim:

<http://www.fzo.org.mk/default.asp?ItemID=03745AB41443004A8EAB9A0105914B95>

Ose në linkun e Fondit në youtube:

<https://www.youtube.com/channel/UCXc5Hr1czS6RKf8-4CDFRVA>

Fondi për sigurim shëndetësor i Maqedonisë vazhdimisht angazhohet për avansimin e punës dhe komunikimin me personat e siguar, firmat dhe punonjësit mjekësor për të krijuar një sistem efikas dhe efektiv me qëllim që t'i kënaq pritshmëritë e personave të siguar.